



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2022:107043

Datë: 21.09.2022

Numri i dokumentit: 03442877

P.nr.354/2022
CPK.nr.99/2022

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN–Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Mirvete Alidema, me bashkëpunëtoren profesionale Valbona Abdyli, duke vendosur në procedurën përmbartimore të kreditorës A.B nga Gj..., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Fadil Sinanaj avokat nga Gjilani, kundër debitorit Komuna e Gjilanit- QKMF në Gjilan, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, jashtë seancës më datë 20.09.2022, mori këtë :

A K T V E N D I M

I.REFUZOHET si i pa bazuar prapësimi i datës 06.05.2022, i debitorës Komuna e Gjilanit-QKMF në Gjilan, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.354/22 të datës 28.04.2022, të Përmbartuesit Privat Kushtrim M. Musa nga Gjilani dhe i njëjti urdhër mbetet në fuqi.

II. Detyrohet debitorit që kreditorës t'ia paguaj shpenzimet e procedurës përmbartimore në shumë prej 117€.

A r s y e t i m i

Përmbartuesi Kushtrim M. Musa nga Gjilani ka lëshuar Urdhërin Përmbartimor të propozuar nga kreditorja, të cilin me autorizim e përfaqëson Fadil Sinanaj avokat nga Gjilani, kundër debitorës Komuna e Gjilanit-QKMF në Gjilan, lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 134.00 Euro, sipas aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, me numër C.nr.2347/2020 të datës 30.12.2021, i ekzekutueshëm me datë 24.01.2022, si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës përmbartimore, për përpilimin e propozimit për përmbartim, sipas numërit tarifor 6 të tarifës së OAK-së, dhe shpenzimet e tjera eventuale.

Debitorja, pas pranimit të Urdhrit Përmbartimor, në afat ligjor me datë 06.05.2022 ka paraqitur prapësim, me të cilin e ka kundërshtuar urdhërin e Përmbartuesit Privat, duke theksuar se me propozimi i mungon baza ligjore nga fakti se Ligji për Procedurën Përmbartimore (tani e tutje referuar si LPP) përcakton se kompetente për zbatim të aktgjykimeve-aktvendimeve të kësaj

natyre që lidhen me marrëdhënie të punës është Gjykata Themelore në Gjiilan- Zyra përmbarimore.

Kreditori, në përgjigjen në prapësim të datës 12.05.2022, thekson se pretendimi i debitorës nuk qëndron pasi që në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me kërkesë nga marrëdhënia e punës, po kemi të bëjmë me shpenzimet e procedurës kontestimore, të cilat shpenzime janë krijuar me fajin e të paditurës, e jo me çështje nga marrëdhënia e punës. I ka kërkuar shpenzimet e procedurës për përpilimin e përgjigjes në prapësim në shumë prej 117€.

Gjykata, pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve të palëve vërtetoi se prapësimi i debitorës është i pabazuar, pasi që i njëjti nuk ka vërtetuar asnjërin nga shkaqet që janë paraparë në nenin 71 të LPP-së lidhur me besueshmërinë e prapësimi, në anën tjetër gjykata ka parasysh nenin 5 par. 6, të LPP-së “Gjykata është kompetente të vendos në procedurën e përmbarimit dhe të zbatoj përmbarimin e vendimeve gjyqësore lidhur me: 6.1. të gjitha çështjet nga e drejta familjare dhe 6.2. kthimin e punëtorëve dhe shërbyesve civil në punë dhe kompensimet tjera” Mirëpo, gjykata duke pasur parasysh, parimin kryesor procedural atë të efikasitetit të procedurës, si dhe duke marrë parasysh faktin se në këtë çështje kemi të bëjmë vetëm me përmbarimin e shpenzimeve të procedurës kontestimore, në bazë të një dokumenti të përshtatshëm për përmbarim, e jo me kthim të punëtorit në punë apo ndonjë kompensim tjetër që rrjedhë nga marrëdhënia e punës.

Nga këto arsye të cekura më lartë gjykata vendosi si dispozitivin e këtij aktvendimi.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 452 par. të LPK-ës, e duke u bazuar në nenin 17 të LPP, përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën kontestimore, po qe se me këtë ligj ose me ndonjë ligj tjetër nuk parashihet diçka tjetër

Prandaj, nga të cekurat më lart e në pajtim me nenin 5, 22, 71, 73 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
CPK.nr.99/2022, datë 20.09.2022

Gjyqtarja,
Mirvete Alidema

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, brenda 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi. Ankesa eventuale dorëzohet përmes kësaj gjykate.